



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Elbasan, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025

**Procesverbal -Tipi i kontrates - Shërbim**

*(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)*

OBJEKTI I PROÇEDURËS: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” i ndarë në lote si më poshtë:

- **Loti I: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-1, ngastra 12/c dhe ekonominë pyjore Gjinar-Zavalinë, ngastra pyjore nr. 138/a me fond limit 5,627,930 lekë.**
- **Loti II: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: “Shpat-2”, ngastra pyjore nr. 19/b, me fond limit 2,288,635 leke.**

**LLOJI I PROÇEDURËS- “Procedurë e Hapur e thjeshtuar –shërbim”**

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - **7,916,565** (shtatëmilion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) **lekë pa t.v.sh** i ndarë në lote si më poshtë:

- **Loti I: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: Shpat-1, ngastra 12/c dhe ekonominë pyjore Gjinar-Zavalinë, ngastra 138/a me fond limit 5,627,930 (pesëmiljon e gjashtëqind e njëzet e shtatëmijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa t.v.sh;**
- **Loti II: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: “Shpat-2”, ngastra 19/b, me fond limit 2,288,635 (dymiljon e dyqind e tetëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa t.v.sh.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 77220000-8 - Shërbime të trajtimit të lëndëve drusore.

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## Shtojca 9

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- aa) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

**Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit nr.08, date 23.09.2024, të miratuara nga APP.

**Loti I: “Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri” në ekonominë pyjore: “Shpat-1”, ngastra 12/c dhe ekonominë pyjore “Gjinar-Zavalinë”, ngastra 138/a.**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteri (a) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas shtojcës 9

**2.1.1** Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2025 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nënshes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, referuar nenit 42 pika 3, 43 pika 2/c dhe nenit 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021

“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

## 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

**2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme,** në një vlerë jo më të vogël se **20 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara,

**ose**

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

| Lloji i Makinerive                                  | Njesia | Sasia |
|-----------------------------------------------------|--------|-------|
| Kamion transporti me kapacitet transporti mbi 7 ton | copë   | 1     |
| Fadrome/Eskavator/Traktor me thike                  | copë   | 1     |

|                                   |      |   |
|-----------------------------------|------|---|
| Organellë ose Traktor teknologjik | copë | 1 |
| Motorrsharre                      | copë | 2 |

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

**a) Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**

ose

**b) Kontratën e marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

- *Për mjetet në pronësi ose të marra me qira si me lart që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, nenit 42 pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Mjetet që duhen për realizimin e shërbimit do të jenë si mëposhte:

1. Mjet transporti për drutë e zjarrit nga ngastra për në fushën e bashkisë. Është kërkuar 1 kamion mbi 7 ton duke patur parasysh sasinë e drutë të zjarrit dhe distancën nga ngastra tek fusha e bashkisë.
2. Mjet për hapjen e rrugëve të brendëshme dhe mirembajtjen e rrugës auto është kërkuar 1 fadrome/ekskavator/traktor me thikë. Përcaktimin e numrit dhe llojit të mjeteve për mirembajtjen e rrugëve auto ku do transportohet drutë e zjarrit që nuk janë në vartësi të bashkisë. Për të realizuar mirembajtjen e rrugëve auto që do shërbejnë për transportin e drutë të zjarrit, që nuk janë në vartësi të Bashkisë, por mirembahen nga subjekti, nga pastrimi nga dëbora, nga rrëshqitjet e dherave, mbushjen e shtratit të rrugës ku krijohen gropa me çakell janë parashikuar këto mjete:

Për mirembajtjen e rrugës Bukanik (Gjinar) – deri në ngastrën pyjore nr. 18/a dhe 143/a ekonomia pyjore "Shpat-1" dhe "Gjinar-Zavalinë" ; si dhe për hapjen e rrugëve të brendshme për secilën ngastrë pyjore nevojitet një fadromë/ekskavator apo traktor me thikë.

3. Organellë ose Traktor teknologjik 1 copë (për transportin e brendëshëm të materialit drusor lëndë punimi (Trupa dhe Lëndë e hollë)
4. Motosharrë për prerje 2 copë. Kërkesa është në përputhje me zerat e preventivit për prodhimin dru zjarri.

**2.3.3- Një punësim mesatar prej 9 (nëntë) punonjës, për muajin e fundit të vërtetuar me;**

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punëtore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Argumentimi. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4, gërma c, nenit 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që opertoret ekonomike të deshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen.

**1.Në përcaktimin e numurit mesatar të punonjësve prej 9 punonjës, janë analizuar:**

**1.1 Prodhimi dru zjarri me motosharrë nevojiten 6 (gjashtë) punëtorë.**

Në pyje operojnë brigata komplekse ku sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjorë nr. operacionit 37/B-b (dru zjarri) dhe 28 (trupa dhe lëndë ndertimi) norma ditore është 22 mst/8 orë dhe 29 m<sup>3</sup>/8 orë. Brigatat që kryejnë këtë shërbim janë komplekse dhe përbëhen nga 6 punëtorë (1 motosharrist dhe 5 punëtorë prodhimin).

Në raport me volumin prej 1497 mst dru zjarri dhe 147 m<sup>3</sup> lëndë punimi (Trupa dhe lëndë e hollë). Për këto volume dhe në raport me normat e punës të specifikuar në librin e normave të shfrytëzimit pyjor, për secilin nga asortimentet drusore sipërcituara, relativisht nevojitet një periudhë kohore prej rreth 3.4 muaj, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj për realizimin e këtij shërbimi nevojiten 6 punëtorë.

**1.2 Transport dru zjarri me kafshë dhe lëndë punimi me krahë, nevojiten 1 punëtor.**

Në kryerjen e këtij shërbimi në pyje në llogaritjen e nr. të punëtorëve janë marrë për bazë distanca e transportit me kafshë, pjerrësia e terrenit dhe rezulton që një punëtor duke përfshirë edhe punën e kafshës, nxjerr në ditë afërsisht 6 - 9 mst/8 orë dru zjarri. Për transportin e vullmit prej 1497 mst dru zjarri dhe 147 m<sup>3</sup> lëndë punimi (61 m<sup>3</sup> me krahe), nevojiten rreth 11.5 muaj/1 punëtor, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj. Për realizimin e këtij shërbimi nevojiten rreth 2 punëtorë për rreth 6 muaj ose rreth 2 muaj për 6 punëtorë.

### **1.3. Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet, shkarkim dru zjarri me krahë nga automjeti dhe stivim dru zjarri me krahë nevojiten 1 punëtor.**

- Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 92 norma ditore është 18 mst/8 orë. Për ngarkimin me krahë në automjet te volumit prej 1497 mst dru zjarri, për realizimin e këtij shërbimi, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, nevojiten 1 puntorë/ për 3.8 muaj, ose 6 punëtorë përrreth 0.6 muaj.

- Shkarkim dru zjarri me krahë nga automjeti.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 103 norma ditore është 55 mst/8orë. Për shkarkimin druve të zjarrit me krahë nga automjeti të volumit prej 1497 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij shërbimi nevojitet 1 puntorë/ për 1.2 muaj, ose rreth 0.2 muaj për 6 punëtor.

- Stivim dru zjarri me krahë.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 114 norma ditore është 33 mst/8 orë. Për stivimin druve të zjarrit me krahë të volumit prej 1497 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj për realizimin e këtij shërbimi 1 puntorë për rreth 2 muaj ose 0.35 muaj per 6 puntor.

Proçeset e shërbimit ngarkim, shkarkim dru zjarri me krah nga automjeti dhe stivim dru zjarri me krahë janë planifikuar sipas grafikut të kryhen brenda periudhes 7 mujore mbasi për periudhën Dhjetor - Prill mjetet e transportit nuk futen për ngarkesë në ngastrat pyjore.

### **1.4. Pastrimi parceles dhe grumbullim mbeturina togje nevojiten 1 puntorë.**

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 77 norma ditore është 0.08 ha/8orë. Për pastrimin e sipërfaqes dhe grumbullimin e mbeturinave në togje prej 10 ha, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij operacioni për rreth 6 muaj nvojiten 1 puntorë (ose 6 punëtorët prodhimit e realizojnë këtë proces për rreth 1 muaj

### **1.5 Transport dru zjarri me automjet nga ngastrat në fushën e Bashkisë Elbasan dhe manovrator për hapjen dhe mirmbajtjen e rrugëve nevojiten 1 puntorë (shofer).**

Sasia e druve të zjarrit që do të transportohet me automjet është 1497 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 dite/muaj dhe llogaritet afërsisht 4.3 muaj mbasi në muajt Janar – Prill nga bllokimi i rrugëve nga dëbora dhe ngrica nuk transportohet dhe pjesa tjetër e ditëve brenda 8 mujorit punohet pjesërisht për shkak të ngricave reshjeve të dëborës shiut dhe difekteve teknike që pësojnë mjetet nga rrugët e vështira të pyllit. Pësia e druve të zjarrit për 1 Ton është 2.32 mst. Për të realizuar shërbimin e plotë të transportit të druve të zjarrit nga ngastra për në fushën e Bashkisë, nevojiten 2 kamion (1 kamion në punë + 1 në gadishmëri) me tonazh mbi 7 ton, duke transportuar afërsisht 16 mst dru zjarri në ditë për kamion, nevojitet 1 punonjës (shofer) për rreth 4.3 muaj.

### **NË TOTAL NEVOJITEN:**

6 - punëtorë që do të bëjnë prerjen, asortimin, transporti brendëshëm, ngarkim, shkarkim dhe stivim (për një periudhë kohore afërsisht 7-8 muaj).

1 - Punëtor do të bëjë pastrimin e parcelës

1 – punëtor duhet për transportin me automjet të materialit drusor dhe si manovrator (për hapjen e rrugëve të brendëshme në ngastrat pyjore, objekt i këtij loti).

1 – punonjës (Drejtuesi teknik)

Theksojmë që numuri 9 i punonjësve të përcaktuar është numri minimal për kryerjen e proceseve të këtij shërbimi, mbasi kryerja e proceseve të shërbimit është e kufizuar dhe varet nga ecuria e kushteve klimaterike, ngastrat pyjore të planifikuara për këtë aktivitet ndodhen në lartësi të madhe mbi nivelin e detit dhe gjendja teknike e rrugëve auto për transportin e druve të zjarrit është e shumë e keqe.

**2.3.4-** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të nje deklarate nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit, Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrate pune, "**Çertifikatë profesionale të ekspertit**", për kategorinë përkatëse, referuar V.K.M nr. 288, datë 29.04.2022 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, kriterëve për pajisjen me çertifikatë eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave", si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për, për **muajin e fundit**.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Kriteri **2.3.4** është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kerkohet që opertoret ekonomike të deshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e shërbimit objekt prokurimi.

*Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 2.2.1 e pikës 2.2 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar- të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 2.3.1, 2.3.2 dhe 2.3.3 të pikës 2.3 -Kapaciteti Teknik- të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Loti II: "Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri" në ekonominë pyjore: "Shpat-2" ngastra pyjore nr. 19/b.**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteri (a) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas shtojcës 9

**2.1.1** Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2025 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40 %** e vlerës së fondit limit që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, referuar nenit 42 pika 3, 43 pika 2/c dhe nenit 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së perilogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvjes së meparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara,

**ose**

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

| <b>Lloji i Makinerive</b>                           | <b>Njesia</b> | <b>Sasia</b> |
|-----------------------------------------------------|---------------|--------------|
| Kamion transporti me kapacitet transporti mbi 7 ton | copë          | <b>1</b>     |
| Fadrome/Eskavator/Traktor me thike                  | copë          | <b>1</b>     |
| Organellë ose Traktor teknologjik                   | copë          | <b>1</b>     |
| Motorrsharë                                         | copë          | <b>1</b>     |

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

**b) Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**

**ose**

**b) Kontratën e marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

- *Për mjetet në pronesi ose të marra me qira si më lart që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, nenit 42 pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Mjetet që duhen për realizimin e shërbimit do të jenë si mëposhte:

1. Mjet transporti për drutë e zjarrit nga ngastra për në fushën e bashkisë. Është kërkuar 1 kamion mbi 7 ton duke patur parasysh sasinë e drutë të zjarrit dhe distancën nga ngastra tek fusha e bashkisë.
2. Mjet për hapjen e rrugëve të brendshme dhe mirëmbajtjen e rrugës auto është kërkuar 1 fadromë/ekskavator/traktor me thikë. Përcaktimin e numrit dhe llojit të mjeteve për mirëmbajtjen e rrugëve auto ku do transportohet drutë e zjarrit që nuk janë në vartësi të bashkisë. Për të realizuar mirëmbajtjen e rrugëve auto që do shërbejnë për transportin e drutë të zjarrit, që nuk janë në vartësi të Bashkisë, por mirëmbahen nga subjekti, nga pastrimi nga dëbora, nga rrëshqitjet e dherave, mbushjen e shtratit të rrugës ku krijohen gropa me çakell janë parashikuar këto mjete:  
Për mirëmbajtjen e rrugës Gjinar – deri në ngastrën pyjore nr. 19/b ekonomia pyjore ”Shpat-2”, si dhe për hapjen e rrugëve të brendshme në ngastrën pyjore, objekt i këtij loti nevojitet një fadromë/ekskavator apo traktor me thikë.
3. Organellë ose Traktor teknologjik 1 copë (për transportin e brendshëm të materialit drusor lëndë punimi (Trupa dhe Lëndë e hollë)
4. Motosharrë për prerje 1 copë. Kërkesa është në përputhje me zerat e preventivit për prodhimin e dru zjarri.

**2.3.3-** Nje punësim mesatar prej 8 (trembëdhjetë) punonjës, për **muajin e fundit** të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punëtore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma c, nenit 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me ane të këtij kriteri kërkohej që opertoret ekonomike të deshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen.

**1. Në përcaktimin e numrit mesatar të punonjësve prej 8 punonjës, janë analizuar:**

**1.1 Prodhimi dru zjarri me motosharrë nevojiten 6 (gjashtë) puntorë.**

Në pyje operojnë brigata komplekse ku sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjorë në nr. operacionit 37/B-b (dru zjarri) dhe 28 (trupa dhe lëndë ndertimi) norma ditore është 22 mst/8 orë dhe 29 m<sup>3</sup>/8 orë. Brigatat që kryejnë këtë shërbim janë komplekse dhe përbëhen nga 6 puntorë (1 motosharrist dhe 5 puntorë prodhimi).

Në raport me volumin prej 569 mst dru zjarri dhe 217 m<sup>3</sup> lëndë punimi (Trupa dhe lëndë e hollë). Për këto volume dhe në raport me normat e punës të specifikuar në librin e normave të shfrytëzimit pyjor, për secilin nga asortimentet drusore sipërcituara, relativisht nevojitet një periudhë kohore prej rreth 1.5 muaj, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj për realizimin e këtij shërbimi nevojiten 6 puntorë.

**1. Transport dru zjarri me kafshë dhe lëndë punimi me krahë, nevojiten 1 puntorë.**

Në kryerjen e këtij shërbimi në pyje në llogaritjen e nr. të puntorëve janë marrë për bazë distanca e transportit me kafshë, pjerrësia e terrenit dhe rezultoni që një puntor duke përfshirë edhe punën e kafshës, nxjerr në ditë afërsisht 6 - 9 mst/8 orë dru zjarri. Për transportin e volumit prej 569 mst dru zjarri dhe 217 m<sup>3</sup> lëndë punimi (87 m<sup>3</sup> me krahe), nevojiten rreth 4.6 muaj/1 punëtor, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj. Për realizimin e këtij shërbimi nevojiten rreth 1 puntorë për rreth 4.6 muaj ose rreth 0.8 muaj për 6 punëtorë.

**1.3. Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet, shkarkim dru zjarri me krahë nga automjeti dhe stivim dru zjarri me krahë nevojiten 1 puntorë.**

- Ngarkim dru zjarri me krahë në automjet.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjorë në nr. operacionit 92 norma ditore është 18 mst/8 orë. Për ngarkimin me krahë në automjet të volumit prej 569 mst dru zjarri, për realizimin

e këtij shërbimi, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, nevojiten **1 puntorë/** për 1.4 muaj, ose 6 punëtorë përrreth 0.25 muaj.

- Shkarkim dru zjarri me krahë nga automjeti.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 103 norma ditore është 55 mst/8orë. Për shkarkimin druve të zjarrit me krahë nga automjeti të volumit prej 569 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij shërbimi nevojitet **1 puntorë/** për rreth 0.5 muaj, ose rreth 0.1 muaj për 6 punëtor.

- Stivim dru zjarri me krahë.

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 114 norma ditore është 33 mst/8 orë. Për stivimin druve të zjarrit me krahë të volumit prej 569 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj për realizimin e këtij shërbimi **1 puntorë** për rreth 0.8 muaj ose 0.15 muaj për 6 puntor.

Proçeset e shërbimit ngarkim, shkarkim dru zjarri me krah nga automjeti dhe stivim dru zjarri me krahë janë planifikuar sipas grafikut të kryhen brenda periudhes 7-8 mujore mbasi për periudhën Dhjetor - Prill, mjetet e transportit nuk futen për ngarkesë në ngastrat pyjore.

#### **1.4. Pastrimi parces dhe grumbullim mbeturina togje nevojiten 1 puntorë.**

Sipas librit të normave të shfrytëzimit pyjore në nr. operacionit 77 norma ditore është 0.08 ha/8orë. Për pastrimin e sipërfaqes dhe grumbullimin e mbeturinave në togje prej 12 ha, ku koha aktive e punës është 22 ditë në muaj, për realizimin e këtij operacioni për rreth 6.8 muaj nevojiten **1 puntorë** (ose 6 punëtorët prodhimit e realizojnë këtë proces për rreth 1.1 muaj).

#### **1. Transport dru zjarri me automjet nga ngastrat në fushën e Bashkisë Elbasan dhe manovrator për hapjen dhe mirmbajtjen e rrugëve nevojiten 1 puntorë (shofer).**

Sasia e druve të zjarrit që do të transportohet me automjet është 569 mst dru zjarri, ku koha aktive e punës është 22 ditë/muaj dhe llogaritet afërsisht 4.3 muaj mbasi në muajt Janar – Prill nga bllokimi i rrugëve nga dëbora dhe ngrica nuk transportohet dhe pjesa tjetër e ditëve brenda 8 muajit punohet pjesërisht për shkak të ngricave reshjeve të dëborës shiut dhe difekteve teknike që pësojnë mjetet nga rrugët e vështira të pyllit. Pësha e druve të zjarrit për 1 Ton është 2.32 mst. Për të realizuar shërbimin e plotë të transportit të druve të zjarrit nga ngastra për në fushën e Bashkisë, nevojiten 1 kamion me tonazh mbi 7 ton, duke transportuar afërsisht 16 mst dru zjarri në ditë për kamion, nevojitet **1 punonjës** (shofer) për rreth 1.6 muaj.

#### **NË TOTAL NEVOJITEN.**

**6 - punëtorë që do të bëjnë prerjen, asortimin, do të bëjnë gjithashtu dhe pastrimin e parcelës pyjore (për një periudhë kohore afërsisht 7-8 muaj).**

**1- Punëtor do të bëjë ngarkimin, shkarkimin dhe stivimin në fushë.**

**1 – punëtor duhet për transportin me automjet dhe si manovrator.**

**1 – punonjës (Drejtuuesi teknik).**

Theksojmë që numuri 8 i punonjësve të përcaktuar është numuri minimal për kryerjen e proçesëve të këtij shërbimi, mbasi kryerja e proçesëve të shërbimit është e kufizuar dhe varet nga ecuria e kushteve klimaterike, ngastrat pyjore të planifikuara për këtë aktivitet ndodhen në lartësi të madhe mbi nivelin e detit dhe gjendja teknike e rrugëve auto për transportin e druve të zjarrit është e shumë e keqe.

**2.3.4-** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të nje deklarate nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit, Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrate pune, "**Çertifikatë profesionale të ekspertit**", për kategorinë përkatëse, referuar V.K.M nr. 288, datë 29.04.2022 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, kritereve për pajisjen me çertifikatë eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave", si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për, për **muajin e fundit**.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Kriteri **2.3.4** është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e shërbimit objekti prokurimi.

***Shënim:** Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 2.2.1 e pikës 2.2 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar- të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 2.3.1, 2.3.2 dhe 2.3.3 të pikës 2.3 -Kapaciteti Teknik- të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 15, pika 3/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

## **NJESIA E PROKURIMI**